VENDIM
Nr.894, datë 22.12.2004

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.437, DATË 3.9.1993 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR PAGAT E PUNONJËSVE TË TATIMEVE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të shkronjave "ç" e "dh" të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 "Për kompetencat për caktimin e pagave të punës", të ndryshuar, dhe të nenit 7 të ligjit nr.9165, datë 23.12.2003 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2004", me propozimin e Ministrit të Shtetit për Koordinimin dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në pikën 3 të vendimit nr.437, datë 3.9.1993 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) Paragrafi i parë ndryshohet si më poshtë vijon:

"Numri i klasave dhe madhësia e pagës bazë mujore, për çdo klasë (së bashku me kompensimin e shpenzimeve nga rritja e çmimeve të bukës dhe të disa artikujve ushqimorë për vetë të punësuarin) për punonjësit e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe të degëve në varësi të saj, janë përkatësisht sipas Lidhjes nr.1 "Paga bazë sipas klasave për punonjësit tatimorë", që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.".

b) Pas paragrafit të parë, shtohet paragrafi më këtë përmbajtje:

"Punonjësve tatimorë, që marrin paga sipas Lidhjes nr.1 të këtij vendimi, u jepet shtesë mbi pagën bazë mujore, në masën 1 (një) për qind, për çdo vit pune, por jo më shumë se 25 vjet. Për llogaritjen e kësaj shtese të njihet vjetërsia e përgjithshme në punë.".

c) Paragrafi i tretë ndryshohet si më poshtë vijon:

"Drejtori i Departamentit të Administratës Publike dhe Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve të përcaktojnë klasën përkatëse të pagës, për çdo pozicion pune, për punonjësit e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe punonjësit tatimorë të degëve në varësi të saj, sipas vendit të punës, nivelit arsimor, vështirësisë në detyrë dhe rrethanave të tjera të kësaj natyre.".

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, për vitin 2004, të përballohen nga fondet buxhetore për këtë vit për paga e sigurime shoqërore, të miratuara për Drejtorinë e Përgjithshme të tatimeve.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1 korrik 2004.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

LIDHJA NR.1

PAGA BAZE SIPAS KLASAVE PER PUNONJESIT TATIMORE

Nr rendor	Klasa	Paga baze Mujore ne leke
1	I	10800
2	II	11750
3	III	12300
4	IV	12700
5	V	13100
6	VI	13900
7	VII	14200
8	VIII	14500
9	IX	15600
10	X	17100
11	XI	17800
12	XII	18300
13	XIII	19100
14	XIV	19700
15	XV	20200
16	XVI	20700
17	XVII	21000
18	XVIII	21500
19	XIX	21800
20	XX	23500
21	XXI	26000
22	XII	28000